



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVA

KOMISIONI I PAVARUR I MEDIAVE
NEZAVISNA KOMISIJA ZA MEDIJE
INDEPENDENT MEDIA COMMISSION



Biznesi: "Klan Kosova" SH.P.K.
NUI: 810795297
Pronari: Aleksandër FRANGAJ
OSHMA: KLAN KOSOVA
Adresa: Zona Industriale, Prishtinë

Biznesi: "Klan Kosova" SH.P.K.
NUI: 810795297
Kandidati: "KG Media Investments" Dooel
EMBS: 7115326
Pronari: Kushtrim GOJANI
Adresa: Zona Industriale, Prishtinë


VENDIM

për ndryshimin e pronësisë, respektivisht pronarit si person fizik të OSHMA Klan Kosova - me seli në Komunën e Prishtinës

Fakte

1. Komisioni i Pavarur për Media (KPM), është organ i pavarur i cili është kompetent për rregullimin, menaxhimin dhe mbikëqyrjen e spektrit të frekuencave të transmetimit. KPM-ja rregullon të drejtat, detyrimet si dhe përgjegjësitë e personave fizik dhe juridik të cilët ofrojnë shërbimet mediale audio dhe audiovizuale.
2. Klan Kosova është Ofrues i Shërbimeve Mediale Audiovizuale (OSHMA - TV), i cili është licencuar nga Komisioni i Pavarur për Media (KPM), për transmetimin e programeve televizive përmes sistemit të operatorëve të shpërndarjes. KPM, me datën 18 shkurt 2009, ka marr vendim për dhënien e licencës për OSHMA Klan Kosova, për një afat të licencës prej dhjetë (10) vitesh, ndërsa më datën 22 shkurt 2019, KPM ka marrë vendim për ripërtitjen e licencës edhe për një afatë prej dhjetë (10) viteve.
3. Me datën 9 tetor 2020, OSHMA Klan Kosova ka dorëzuar një kërkesë në Zyrën Ekzekutive të KPM-së, përmes së cilës ka kërkuar miratimin e KPM-së për ndryshimin e pronësisë së OSHMA Klan Kosova, respektivisht të pronarit si person fizik dhe bartjen e licencës nga z. Aleksandër Ferangaj tek personi juridik "KG Media Investments" Dooel me numër të biznesit (EMBS) 7115326, në kuadër të biznesit ekzistues në emër të cilit është lëshuar licenca e OSHMA Klan Kosova – "Klan Kosova" SH.P.K. me NUI 810795297.


Arsyetim



4. Neni 21, paragrafi 3 i Ligjit të KPM-së përcakton se: *“licencat nuk mundë të shfrytëzohen dhe bKlan Kosovaën pa autorizim dhe pa aprovim paraprakë me shkrim të KPM-së”*.
5. Neni 15. pika 2. Paragrafi 1 i Kushteve dhe termeve të Përgjithshme të Licencës së KPM-së ka siguruar që: *“Për çdo ndryshim në pronësi që kap më shumë se 10% të aksioneve të interesave ose ato që kanë ndikim të theksuar në kontrollin e të Licencuarit, kërkohet paraprakisht aprovimi me shkrim nga ana e KPM-së”*
6. Neni 15.4 i Kushteve dhe termeve të Përgjithshme të Licencës së KPM-së ka siguruar që: *“KPM-ja do të lejojë transferimin e licencës vetëm kur sigurohet që personi fizik apo juridik, për të cilin propozohet që t’i transferohet licenca, i plotëson standardet e KPM-së për t’iu dhënë një licencë.”*
7. Komisioni konstaton se, kandidati i propozuar për pronar të ri të OSHMA Klan Kosova, ka shprehur gatishmëri që, ofrimin e shërbimeve mediale audiovizuale për publikun do të bëjë në pajtueshmëri me Ligjin dhe aktet nënligjore të KPM-së dhe në interes të publikut, duke e rritur cilësinë e programeve të ofruara.
8. Duke u bazuar në gatishmërinë e shprehur të kandidatit për pronar të ri për të punuar në pajtim me Ligjin dhe aktet nënligjore të KPM-së, dhe deklarin e tij për të ofruar programe cilësorë për publikun, Komisioni vlerëson se ndryshimi i pronësisë së OSHMA Klan Kosova është në interes të publikut.
9. Komisioni vlerëson se, kërkesa është bërë në pajtim me procedurat e KPM-së, të bazuara në Ligjin dhe aktet nënligjore të KPM-së dhe si e tillë i plotëson kriteret për miratim.

Vendim

10. Komisioni, në takimin e tij të mbajtur me datën 15 dhjetor 2020, merrë vendim për miratimin e kërkesës për ndryshimin e pronësisë së OSHMA Klan Kosova, respektivisht ndryshimit të pronarit si person fizik dhe bartjen e licencës nga z. Aleksandër Ferangaj tek personi juridik “KG Media Investments” Dooel me numër të biznesit (EMBS) 7115326, në kuadër të biznesit ekzistuesë, në emër të së cilit është lëshuar licenca e OSHMA Klan Kosova – “Klan Kosova” SH.P.K. me Numër Unik Identifikues 810795297.
11. Komisioni rekomandon që përveq ndryshimeve në pronësi nuk do të ketë ndryshime tjera në licencën e transmetimit të OSHMA Klan Kosova.
12. Këtë vendim e lëshon Komisioni, dhe i njëjti hyn në fuqi nga data e nënshkrimit.


Xhevat LATIFI
Kryetar

Komisioni i Pavarur i Mediave



15.12.2020
datë